



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1225/1 prot.

Tiranë më 20.08.2019

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Për dijëni: **INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E
KOMUNIZMIT**

Tiranë

Zyra e Komisionerit ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për interpretim me nr. 4750/3 Prot. datë 31.07.2019, lidhur me kërkesën e paraqitur nga Instituti i Studimeve për krimet dhe Pasojat e Komunizmit, nëpërmjet të cilës kërkohet akses në informacione specifike (kopje të akteve në dosje, vendime gjyqate dhe vërtetime për hyrje daljet nga burgu), në kuadër të ligjit nr. 9831/2007 "*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist*" i ndryshuar.

Në çdo rast, Zyra e Komisionerit ka si synim kryesor mbrojtjen e interesave të subjekteve të të dhënave personale, dhe është shumë e vëmendshme në trajtimin e rasteve në përputhje me kompetencat dhe procedurat ligjore përkatëse.

Ligji nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, zbatohet për përpunimin e të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike, si dhe për përpunimin me mjete të tjera të të dhënave personale, që mbahen në një sistem arkivimi apo kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit.

Referuar ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, subjektet kontrolluese gjatë përpunimit të të dhënave personale, duhet të kenë parasysh respektimin dhe garantimin e parimeve për mbrojtjen e të dhënave personale sanksionuar në nenin 5, si dhe plotësimin e kushteve të sanksionuara në nenin 6 të këtij ligji.

Ligji parashikon përpunimin e veçantë të të dhënave personale në Kreun III, dhe në pikën 2 të nenit 10 të tij, parashikon se: "*Transmetimi i të dhënave sensitive për kërkimet shkencore bëhet vetëm kur ekziston një interes i rëndësishëm publik. Të dhënat personale përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin*".

Pika 2 e nenit 6 të ligjit nr. 10242/2010 "Për institutin e studimeve për krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri" parashikon: "Të gjitha strukturat dhe organet shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat, tërësisht ose pjesërisht buxhetore, organizatat që financohen nga qeverisja vendore, arkivat dhe të gjitha njësitë apo strukturat e tjera, që disponojnë dokumente e materiale arkivore, që i përkasin periudhës së komunizmit dhe që mund t'i shërbejnë realizimit të veprimtarisë së institutit, janë të detyruara t'ia vënë ato në dispozicion dhe t'i ofrojnë institutit asistencën e nevojshme, pa pagesë dhe pa vonesë të pajustificuar. Instituti ka të drejtë të bëjë kopje të dokumenteve dhe të materialeve arkivore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat".

Zyra e Komisionerit vlerëson se përhapja e të dhënave drejt palës së tretë, Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, është në përputhje me kriterin ligjor për përpunimin e të dhënave, të parashikuar në gërmën "d", të nenit 6 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat".

Në çdo rast, mbas disponimit të të dhënave dhe në veçanti në rast se kërkohet publikimi i të dhënave, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit duhet të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

